



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Durrës 29.04..2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

- *Lista e operatorëve publikë dhe privat me të cilën institucioni juaj bashkëpunon për menaxhimin e mbetjeve elektronike*

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve urbane, i cili përfshin procesin e evadimit të mbetjeve, të depozitimit, të pastrimit dhe mirëmbajtjes, në Bashkinë Durrës realizohet me anë të dy ndërmarrjeve dhe operatorit ekonomik:

- Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës, i cili ofron shërbimin e tij në njësitë administrative 1, 2, 3, 4, 5 në Durrës, njësinë administrative Manëz dhe njësinë administrative Katundi i Ri,
- Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Plazh e cila operon në lagjen nr. 13, lagjen nr.14 në (Shkozet) dhe Njësinë Administrative Rrashbull,
- Shoqërisë private "AFA GRUP" sh.p.k. e cila operon në njësitë administrative Ishëm dhe Sukth.

Në zbatim të Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr.01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, Vendimin Nr. 438, datë 15.07.2021 “Për Mbështetjen financiare për menaxhimin e mbetjeve në Bashkitë e Qarkut Durrës”, VKM nr. 496, datë 30.07.2021 “Për Miratimin e kërkesës së Bashkisë Durrës për mbështetje financiare nga Qeverisja qendrore për menaxhimin e mbetjeve”, Bashkia Durrës sapo ka lidhur kontratën me Nr. 9853/8 prot. Datë 08.10.2021 me operator Integrated Energy BV SPV shpk administrator i lendfillit të Sharrës, për “Depozitimin e mbetjeve Bashkia Durrës”, me çmim për njësi 3,518.86 Lek /ton pa TVSH. Kontrate, e cila është lidhur pas nje procedure te rregullt prokurimi bazuar në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 47, pika 1, b, ii; si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 52, pika 1, b, ii.

Duke qenë se:

Bazuar në pikën 9.2.2 Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve të VKM nr. 418, datë 25.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020-2035”, ku citohet: “...Çdo bashki duhet të jetë pjesë e një ZMM-je. ZMM-ja të miratohen nga këshillat bashkiakë të njësive që bëjnë pjesë në atë territor dhe autorizohen nga pushteti qendror...”, Për këtë arsye, Bashkia Durrës, me anë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 68,

datë 10.06.2021 “Për miratimin e skenarit të menaxhimit të mbetjeve, bazuar në Vendimin nr. 06, datë 20.05.2021 të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, dhe Vendimin nr. 03, datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës”, ka konfirmuar që është pjesë e ZMM-së së menaxhimit të mbetjeve për zonën Tiranë-Durrës.

Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës nr. 68, datë 10.06.2021 “Për miratimin e skenarit të menaxhimit të mbetjeve, bazuar në Vendimin nr. 06, datë 20.05.2021 të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, dhe Vendimin nr. 03, datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës”, është autorizuar më parë nga pushteti qendror, me anë të Vendimit nr. 06, datë 25.05.2021 të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, dhe Vendimit nr. 03, datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës.

Sasitë e evadimit të mbetjeve përgjatë cdo muaji, për të cilët kryen pagesat janë të ndryshueshme në varësi të evadimit të mbetjeve urbane cdo muaj. Pagesat, bazuar në Vkm nr. 496, datë 30.07.2021 “Për Miratimin e kërkesës së Bashkisë Durrës për mbështetje financiare nga Qeverisja qendrore për menaxhimin e mbetjeve”, si mbështetje financiare nga instancat qendrore, kanë filluar të kryhen pas datës 08.10.2021 kur është lidhur kontrata me operatorin në fjalë.

Aktualisht Bashkia Durrës nuk kryhen diferencim të mbetjeve dhe trajtim të rrymave specifike të mbetjeve, për rrjedhojë nuk menaxhojmë mbetjet elektronike.

- *Sa është sasia vjetore e gjenerimit, grumbullimit dhe trajtimit të MEE në njesinë tuaj vendore në 10 vitet e fundit?*

Ju bejme me dije se nga 2014- 2020 sasia e mbetjeve për Bashkinë Durrës ishte një vlerë relative, pasi mungesa e një peshoreje bente një përafrim nga ana jone e vlerës së mbetjeve të evaduara duke u bazuar në peshën mbajtëse të makinave që kryenin grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane, për aq sa depozitimi përfundimtar për shumë vite realizohet në një vendhedhje të hapur ku nuk kryej asnjë procedurë trajtimi mbetjesh.

Në vitin 2021 me mbështetje të pushtetit qendror mbetjet urbane janë depozituar në Qendren e Menaxhimit të mbetjeve në Tiranë, ku realizohet dhe peshimi i tyre nga një peshore. Për rrjedhojë sasia e mbetjeve rezulton e ndryshueshme për cdo muaj.

Të dhënat e tjera që kërkoni për rryma të caktuara në mungesë të një stacioni transferimi ku do të selektoheshin e bëjnë të vështirë raportimin në vlera të tyre.

- *Në çfarë është arritur objektivin MII i “Dokumentit të politikave strategjike dhe planit kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve” në njesinë tuaj vendore në lidhje me MEE, ku specifikohet se: Te gjitha bizneset që importojnë apo prodhojnë mbetje të rrymave specifike, në zbatim të parimit “te përgjegjësise së zgjeruar të prodhuesit”, ngrenë skemat e vecanta dhe/ose të përbashketa në bashkëpunim me Bashkitë e vendit dhe përdorues të tjerë të mbetjeve specifike si për gomë, bateritë, mbetje elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës, etj. Rikuperimin dhe trajtimin e tyre?*

Momentalisht Ligji nr. 74/2025 “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje” i sapo miratuar është në fazë implementimi deri në daljen e akteve të reja ligjore për rregullimet e detyrave /përgjegjësitë për të gjithë aktorët e përfshirë.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin,

